



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/61


Datë: 22.08.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 gusht 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Letërnjoftim.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrasnjih Poslova
- Ministry of Internal Affairs

KONCEPT DOKUMENT PËR LETËRNJOFTIM

Prishtinë, Qershor 2018

KONCEPT DOKUMENT PËR LETËRNJOFTIMET

Kapitulli I: Hyrje

Dokumentet Qeveritare, të cilat e autorizojnë nxjerrjen (Hartimin) e Koncept Dokumentit për Letërnjoftim janë Programi i Punës së Qeverisë 2017-2021, Planit Vjetor i Punës së Qeverisë (PVPQ), për vitin 2018, Plani Vjetor të Punës së MPB-së, për vitin 2018 dhe Lista e Koncept Dokumenteve të Qeverisë për vitin 2018, e cila listë miratohet nga Sekretari i Përgjithshëm i ZKM-së duke u bazuar në Rregulloren Nr.09/2011 e Punës së Qeverisë.

Ngritja e nivelit të shërbimeve për qytetarët dhe ngritja e efikasitet në administratën publike në shërbimet për qytetarin, si dhe ngritja e sigurisë së dokumenteve (përdorimi i Letërnjoftimit i cili ka fotografi të integruar dhe zëvendësimi i ekstraktit të lindjes) është prioritet i ARC-së, MPB-së dhe Qeverisë së Kosovës. Këtu përfshihet: krijimi i lehtësirave për identifikim më të lehtë të fëmijëve në institucionet shëndetësore, arsimore, qasje në internet dhe shërbime të tjera elektronike, pastaj lëvizje më të lehtë duke pasur parasysh që Letërnjoftimi aktual mund të përdoret si dokument udhëtimi me vendet fqinje dhe vendet e tjera në bazë të marrëveshjeve ndërshtetërore. Po ashtu Qeveria Republikës së Kosovës me këtë rast, do të zbatojë një qasje gjithëpërfshirëse edhe ndaj shtetasve të saj nën moshën 16 vjeçare, pasi që ata do të mund të gëzojnë të drejtat sikurse ata mbi moshën 16 vjeçare, pra pajisje me Letërnjoftim.

Kjo çështje ndërlidhet me prioritetet e Qeverisë, përkatësisht me Programin e Punës së Qeverisë, për vitet 2017-2021, në të cilin plan është paraparë përmirësimi i shërbimeve dhe sigurisë së dokumenteve në agjencinë e regjistrimit civil. Në veçanti në këtë plan është paraparë ndërlidhja e sistemeve të ARC-së me sistemet tjera si Sistemi i Adresave, Sistemet Shëndetësore, Sistemin Arsimor, Sistemin Gjyqësor të Kosovës dhe sistemet e institucioneve tjera publike dhe private. Poashtu, nxjerrja e këtij koncept dokumenti ndërlidhet edhe me objektivin 2 (ruajtja e sigurisë publike si dhe përmirësimi i shërbimeve për qytetarët) të PVP/MPB, për vitin 2018.

Sigurisht se me hartimin dhe miratimin e këtij KD, Qeveria do të realizojë zotimin e saj të dhënë në PVPQ 2018 dhe në Programin e Punës së Qeverisë, për vitet 2017-2021.

Kapitulli II: Përshkrimi dhe definimi i çështjes

Shpjegim dhe definimi i problemit

Aktualisht çështja e të drejtës për tu pajisur me letërnjoftim të shtetit të Kosovës është e rregulluar me Ligjin Nr. 05/L-015 për Letërnjoftim dhe me aktet nënligjore që burojnë nga ky ligj. Konkretisht këto akte normative përcaktojnë kushtet, procedurat dhe organin kompetent për lëshimin e letërnjoftimit dhe përdorimin e tij nga shtetasit e Republikës së Kosovës.

Ligji aktual e obligon shtetasin e Republikës së Kosovës të pajiset me letërnjoftim që nga moshën 16 vjeçare. Por problemi qëndron në atë se ky ligj nuk e rregullon të drejtën e qytetarit për t'u pajisur me letërnjoftim të shtetit të Kosovës, që nga lindja e deri në moshën 16 vjeçare, çështje kjo e cila është nevojë e kohës dhe sigurisht ka edhe dobi të tjera, si për shtetin ashtu edhe për vet qytetarin. Poashtu, duhet të theksohet se nuk ka ndonjë akt normativ i cili aktualisht ose edhe në të kaluarën e ka rregulluar këtë çështje.

Sigurisht që pamundësia e pajisjes me letërnjoftim për këtë kategori e ka obliguar këtë kategori të qytetarëve që të pajisen me pasaporta për të udhëtuar në ato vende ku është e mundur të udhëtohet vetëm me letërnjoftim, gjë që ndikon edhe në rritjen e kostos financiare të pajisjes me pasaportë. Gjithashtu, edhe çështja e gjobave e cila po paraqet vështirësi të zbatimit të ligjit aktual sidomos te dispozitat që parashohin sanksionet të cilat nuk janë të harmonizuara me ligjin e ri për kundërvajtje, ligj i cili kërkon që lidhur me sanksionet kundërvajtëse të bëhet harmonizimi i të gjitha dispozitave të ligjeve tjera me këtë ligj. Kjo vështirësi e zbatimit të ligjit aktual ka filluar të paraqitet nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit të ri për kundërvajtje.

Politika aktuale

Lëshimi i letërnjoftimit aktualisht rregullohet me Ligjin Nr.05/L-015 për Letërnjoftim dhe me aktet nënligjore përkatëse.

Ligjet dhe aktet nënligjore

MPB-ja është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave dhe legjislacionit nga fusha e lëshimit të letërnjoftimeve.

Aktualisht Ligji nr. 05/L-015 për Letërnjoftimin i publikuar në Gazetën Zyrtare nr. 36 me datën 21.12.2015 dhe aktet nënligjore që burojnë nga ky ligj e rregullojnë çështjen e lëshimit të letërnjoftimeve për qytetarët e Kosovës nga mosha 16 vjeçare.

Ligji Nr. 05/L-015 për Letërnjoftimin përcakton rregullat ligjore të dhënies së letërnjoftimit, kompetencën si dhe procedurën e lëshimit të letërnjoftimit për shtetasit e Republikës së Kosovës.

Aktet nënligjore për zbatimin e Ligjit Nr. 05/L-015 për Letërnjoftime:

1. Udhëzimi Administrativ Nr. 13/2016 për Pajisje me Letërnjoftim të Republikës së Kosovës me Procedurë të përshpejtuar: Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është përcaktimi i procedurave të përshpejtuara për pajisje me letërnjoftim të Republikës së Kosovës.

2. Udhëzimi Administrativ Nr. 17/2016 për Procedurat e Pajisjes me Letërnjoftim: Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i procedurave të aplikimit për letërnjoftim për herë të parë, letërnjoftim të humbur/dëmtuar, ndërrimin e të dhënave dhe ripërtëritjen e të dhënave.

3. Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2016 për Përcaktimin e Formës, Përmbajtjes dhe Mënyrës së Punimit të Letërnjoftimit: Qëllimi i këtij udhëzimi është të përcaktojë formën, përmbajtjen dhe mënyrën e punimit të të dhënave në letërnjoftim, të përcaktuara nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Shpenzimet aktuale

Kategoria e shpenzimeve	Shpenzimet faktike ne vitin paraprak	Buxheti këtë vite	KASH për vitin e ardhshëm
Buxheti I departamentit	670,5000	979,060	997,513
Shpenzimet e drejtpërdrejta nga Ministria e Financave	670,5000	979,060	997,513
Buxheti shtesë përletërnjoftime	0.00	0.00	0.00

Vlerësimi plotësues i politikës aktuale

Ligji për letërnjoftim, si dhe aktet nënligjore përkatëse janë mjaft të avancuara dhe nëpërputhje me standardet ndërkombëtare.

Mirëpo, ndryshimi dhe plotësimi i kornizës ligjore aktuale do tu jipte të drejtën edhe qytetarëve të vendit nën moshën 16 vjeçare për tu pajisur me letërnjoftim.

Çështje tjetër është edhe harmonizimi i dispozitave sanksionuese të ligjit aktual për letërnjoftim me dispozitat e ligjit për kundërvajtje.

Përvoja nga shtetet tjera

Nga shtetet e BE-së janë Holanda dhe Lituania të cilat e kanë të rregulluar të drejtën e pajisjes me letërnjoftim për qytetarët e tyre nën moshën 16 vjeçare. Edhe pse këto dy shtete e kanë rregulluar të drejtën e pajisjes me letërnjoftim për këtë kategori të qytetarëve, ata nuk janë të obliguar të pajisen me letërnjoftime.

Qasja e cila mund të ketë sukses në Kosovë është plotësimi ndryshimi i ligjit aktual i cili do tu jipte të drejtën edhe qytetarëve të kësaj kategorie të vendit tonë për tu pajisur me letërnjoftim, ashtu siç e kanë të rregulluar dy shtetet e lartëcekura të BE-së.

Kapitulli III: Synimet dhe objektivat

Synimi

Synimi i përgjithshëm është pajisja e shtetasve të Republikës së Kosovës nën moshën 16 vjeçare me letërnjoftime gjë që do të ndikonte në rritjen e sigurisë publike dhe avancimin e shërbimeve të përgjithshme për këtë kategori të qytetarëve.

Objektivat

Objektivat e propozimit qëndrojnë në dy kategori kryesore siç janë:

1. Pajisja me letërnjoftim e të gjithë qytetarëve nën moshën 16 vjeçare të Kosovës, gjë që do të mundësonte identifikim më të lehtë për qytetarët e kësaj kategorie si dhe lehtësira për udhëtim në vendet ku mund të udhëtohet me letërnjoftime.

2. Forcimi i sigurisë publike dhe avancimi i shërbimeve për qytetarët.

Kapitulli IV: Opsionet

Opsioni 1: Opsioni status quo (asnjë ndryshim)

Mos ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Letërnjoftim, do të ruante status quo-në, duke u pamundësuar kësaj kategorie të qytetarëve që të pajien me letërnjoftim me çka nuk do të ketë përfitim në identifikim më të lehtë, shërbime më të mira dhe mundësi udhëtimi në vendet ku mund të udhëtohet me letërnjoftim.

Nëse baza ligjore dhe politika ekzistuese vazhdon të jetë e njëjtë, do të ketë vështirësi në shqiptimin e gjobave të ligjit aktual të cilat ndërlidhen me ligjin për kundërvajtje.

Opsioni 2: Ndryshimi i politikës ekzistuese

Politika ekzistuese mund të ndryshohet, duke plotësuar dhe ndryshuar ligjin aktual.

Përmes plotësim ndryshimit të ligjit aktual do tu jipet e drejta edhe kategorisë së qytetarëve nën moshën 16 vjeçare që të pajisen me letërnjoftim dhe do të bëhet harmonizimi i dispozitave ligjore të ligjit aktual që me dispozitat e ligjit të ri për kundërvajtje. Përcaktimi dhe rregullimi të këtyre dy çështjeve të lartcekura me ligjin pasues, do të kërkojë edhe plotësim ndryshim të dispozitave të tjera të ligjit aktual sipas nevojës dhe më qëllim për tu harmonizuar edhe me dy çështjet e lartcekura.

Neni 2, nën paragrafi 1.5, i ligjit aktual duhet të ndryshohet dhe termi “nënshkrimi elektronik” ndryshohet dhe bëhet “nënshkrimi në formë elektronike”.

Neni 2, nën-paragrafi 1.10 fjala “ministrisë” hiqet dhe zëvendësohet me fjalinë “organit kompetent”.

Neni 3, i ligjit aktual plotësohet dhe ndryshohet me tekstin si në vijim: 1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës ka të drejtë të pajiset me letërnjoftim. 2. Shtetasi i Republikës së Kosovës nga lindja deri në moshën 16 vjeçare nuk është i detyruar të pajiset me letërnjoftim. 3. Shtetasi i

Republikës së Kosovës nga mosha 16 vjeçare është i detyruar të pajiset me letërnjoftim. Ndërsa, teksti i paragrafit 2 i ligjit aktual mbetet i pandryshuar, vetëm rinumërohet.

Neni 5, paragrafi 4 fjala “ministria” ndryshohet me fjalën “organ kompetent”.

Neni 11, i ligjit aktual plotësohet dhe ndryshohet si në vijim: Paragrafi 1. Letërnjoftimi lëshohet me afat vlefshmërie prej 3 vjetëve për shtetasin nga lindja deri në moshën 3 vjeçare. Paragrafi 2. Letërnjoftimi lëshohet me afat vlefshmërie prej 5 vjetëve për shtetasin nga mosha 3 vjeçare deri në moshën 18 vjeçare. Paragrafi 3. Letërnjoftimi lëshohet me afat vlefshmërie prej 10 vjetëve për shtetasin nga mosha 18 vjeçare.

Neni 12, paragrafit 1 të ligjit aktual i shtohet një nën-paragraf i ri me numër rendor 1.6 me tekstin si në vijim: nëse shtetasi nuk e tërheq letërnjoftimin brenda 6 muajve nga data e njoftimit për tërheqjen e tij, i njëjti dokument do të konsiderohet i pavlefshëm dhe njëkohësisht shkatërrohet nga organi kompetent.

Neni 14, paragrafi 1 i ligjit aktual plotësohet dhe ndryshohet me tekstin si në vijim: Organi kompetent është i detyruar ta lëshojë letërnjoftimin brenda 10 ditësh pune nga dita e paraqitjes së kërkesës. Kurse, paragrafi 3 dhe 4 fshihen.

Neni 16, nën-paragrafi 1.1 i ligjit aktual plotësohet dhe ndryshohet me tekstin si në vijim: ndërron ndonjë nga të dhënat personale nga paragrafi 1 i nenit 9 të ligjit aktual.

Neni 17, paragrafi 3 dhe 4, fjala “ministria” hiqet dhe zëvendësohet me fjalinë “organi kompetent”.

Neni 19, fjala “ministria” hiqet dhe zëvendësohet me fjalinë “organi kompetent”.

Neni 20, paragrafi 1 plotësohet dhe ndryshohet fjalia e tretë “letërnjoftimi pasues i lëshohet në kohëzgjatje prej 1 viti”

Neni 21, paragrafi 2 dhe 4 fjala “ministra” ndryshohet me fjalinë “organ kompetent”.

Neni 22, plotësohet dhe ndryshohet si në vijim:

1. Me gjobë prej dhjetë (10) Euro dënohet shtetasi:

1.1. i cili nuk parashtron kërkesën për pajisje me letërnjoftim të përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 13 të këtij ligji;

1.2. i cili nuk ia dorëzon organit kompetent letërnjoftimin në afatin e caktuar në paragrafin 1 të nenit 16 të këtij ligji;

1.3. i cili në afatin e caktuar me ligj dhe në mënyrë të rregullt nuk e lajmëron organin kompetent për humbjen apo gjetjen e letërnjoftimit, paragrafi 3 dhe 4 i nenit 15 të këtij ligji.

2. Me gjobë prej njëzetë (20) deri në gjashtëdhjetë (60) Euro, dënohet për kundërvajtje shtetasi:

2.1. i cili nuk e ka letërnjoftimin e vlefshëm dhe nuk ka dokument tjetër të vlefshëm identifikues me fotografi, me përjashtim të afatit ligjor për pajisje me letërnjoftim;

2.2. i cili me kërkesën e personit zyrtar, të autorizuar me ligj, letërnjoftimin nuk e posedon me vete, ose nuk dëshiron ta jap për identifikim sipas paragrafit 1 të nenit 4 të këtij ligji;

3. Me gjobë prej njëqind (100) Euro dënohet për kundërvajtje shtetasi:

3.1. i cili letërnjoftimin e tij e jep apo huazon personit tjetër për përdorim ose përdor letërnjoftimin e huaj si të vetin, sipas paragrafit 2 dhe 3 i nenit 4 të këtij ligji;

3.2. përdor letërnjoftimin në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 21 të këtij ligji;

4. Afati i pagesës së gjobës do të jetë sipas Ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje .

Përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është Ministria e Punëve të Brendshme.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit të ri me ndryshimet e propozuara, qytetarët nën moshën 16 vjeçare do të kenë mundësinë të pajisen me letërnjoftim si dhe do të eliminohet mosharmonizimi i dispozitave sanksionuese të ligjit aktual me ligjin për kundërvajtje.

Opsioni 3: Ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit

Mos-ndryshimi i bazës Ligjore, përkatësisht vazhdimi i zbatimit të ligjit aktual do të pamundësonte dhënien e të drejtës së qytetarëve nën moshën 16 vjeçare për tu pajisur me letërnjoftime si dhe do të krijonte vështirësi në zbatim sidomos me rastin e zbatimit të dispozitave sanksionuese të cilat nuk janë në harmoni me ligjin e ri për kundërvajtje. Vetëm ndryshimi i mënyrës së zbatimit të saj do të mundësonte pajisjen me letërnjoftim për të gjithë qytetarët, pa dallim moshe.

Kapitulli V: Përmbledhja e opsioneve

Karakteristikat kryesore	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3
Karakteristikat kryesore të opsionit.	Mbetet situatë e njëjtë, nuk u mundësohet edhe qytetarëve nga lindja deri në moshën 16 vjeçare të pajisen me letërnjoftim, si dhe mos harmonizimi i dispozitave sanksionuese të ligjit aktual me ligjin për kundërvajtje.	Ndryshimi dhe plotësimi i ligjit aktual: u mundësohet edhe qytetarëve nga lindja deri në moshën 16 vjeçare të pajisen me letërnjoftim, si dhe bëhet harmonizimi i dispozitave sanksionuese të ligjit aktual me ligjin për kundërvajtje.	Nëse baza ligjore dhe politika ekzistuese qëndron, atëherë është e pamundur që qytetarët nga lindja deri në moshën 16 vjeçare të pajisen me letërnjoftim, si dhe të bëhet harmonizimi i dispozitave sanksionuese të ligjit aktual me ligjin për kundërvajtje.
Segmenti i	Qytetarët e	Qytetarët e	Qytetarët e

popullsisë / sektori / rajoni i shënjestruar.	Republikës së Kosovës, qytetarëve nga lindja deri në moshën 16 vjeçare, të cilët do të të pajisen me letërnjoftim.	Republikës së Kosovës, qytetarëve nga lindja deri në moshën 16 vjeçare, të cilët do të të pajisen me letërnjoftim.	Republikës së Kosovës, qytetarëve nga lindja deri në moshën 16 vjeçare, të cilët do të të pajisen me letërnjoftim.
Karakteristikat e zbatimit – kush është përgjegjës – një resor i Qeverisë (cili), sektori privat, qytetarët.	Përgjegjës për zbatim është Ministria e Punëve të Brendshme dhe qytetarët	Përgjegjës për zbatim është Ministria e Punëve të Brendshme dhe qytetarët	Përgjegjës për zbatim është Ministria e Punëve të Brendshme dhe qytetarët
Administrimi ose zbatimi i programit ose shërbimit	Zbatimin dhe mbikëqyrjen e bënë Ministria e Punëve të Brendshme.	Zbatimin dhe mbikëqyrjen e bënë Ministria e Punëve të Brendshme.	Zbatimin dhe mbikëqyrjen e bënë Ministria e Punëve të Brendshme.
Ligjet, aktet nënligjore, ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve ekzistuese si dhe zbatimi dhe dënimet.	Pa ndryshime	Ndryshimi apo plotësimi i Ligjit 05-L-015 për Letërnjoftim, si dhe ndryshimi i akteve nën-ligjore përkatëse.	Pa ndryshime
Stimulimet ose mos stimulimet ekonomike – subvencionet ose taksat.	Buxheti i aprovuar	Buxheti i aprovuar	Buxheti i aprovuar
Fushatat e edukimit dhe komunikimit.	Nuk ka	Konferencë për media	Nuk ka
Udhëzimet dhe kodet.	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka
Afatet kohore – kur hyn në fuqi opsioni.	I vazhdueshëm	K4 2018	K4 2018

Si opsion i rekomanduar është plotësim ndryshimi i Ligjit nr.05/L-015 për Letërnjoftim.

Kapitulli VI: Analiza e opsioneve

Përfitimet

1. Opsioni 1: Nuk ka përfitimesepse kjo kategori e qytetarëve edhe më tej nuk do të mund të pajisen me letërnjoftim, dokument i cili do të shërbente për identifikim më të lehtë të fëmijëve në institucionet shëndetësore, arsimore, dhe shërbime elektronike.
2. Opsioni 2: Me plotësim ndryshimin e ligjit aktual do të jipet e drejta për qytetarët nën moshën 16 vjeçare për tu pajisur me letërnjoftim, dokument i cili do të shërbejë për identifikim më të lehtë të fëmijëve në institucionet shëndetësore, arsimore, dhe shërbime elektronike. Poashtu, plotësim ndryshimi i ligjit aktual do të harmonizonte dispozitat e këtij ligji në të cilat parashihen gjobat me dispozitat e ligjit të ri për kundërvajtje.
3. Opsioni 3: Çdo ndryshim i qasjes ekzistuese të zbatimit të ligjit aktual nuk do ti jipte të drejtën qytetarëve nën moshën 16 vjeçare për tu pajisur me letërnjoftim, sepse kjo e drejtë nuk mund tu jipet kësaj kategorie të qytetarëve pa plotësim ndryshimin e ligjit aktual dhe harmonizimin e këtij ligji me legjislacionin tjetër relevant.

Pasojat negative

1. Opsioni 1: Pasojat e këtij opsioni janë të atilla që kjo kategori e qytetarëve edhe më tej do të vazhdojë të ketë vështirësitë e njëjta në identifikim, udhëtim dhe kryerjen e shërbimeve elektronike. Poashtu, pasojë tjetër mund të jetë edhe pamundësia e shqiptimit të gjobave të përcaktuara me ligjin aktual për shkak të mos harmonizimit me ligjin e ri për kundërvajtje.
2. Opsioni 2: Kostoja financiare do të mund të ishte e vetmja pasojë negative, por kur kemi parasysh faktin se me plotësim ndryshimin e ligjit aktual do të krijohet mundësia që edhe qytetarët nën moshën 16 vjeçare të pajisen me letërnjoftim i cili do të lehtësonte identifikim më të shpejtë dhe të saktë nga ana e autoriteteve përkatëse, udhëtimin jashtë vendit dhe shërbimeve elektronike e arsyetojnë këtë kosto.
3. Opsioni 3: Çdo ndryshim i qasjes ekzistuese të zbatimit të ligjit aktual nuk do ti jipte të drejtën qytetarëve nën moshën 16 vjeçare për tu pajisur me letërnjoftim, sepse kjo e drejtë nuk mund ti jipet kësaj kategorie të qytetarëve pa plotësim ndryshimin e ligjit aktual dhe

harmonizimin e këtij ligji me legjislacionin tjetër relevant dhe njëkohësisht do të krijonte vështirësi të vazhdueshme në zbatimin e dispozitave sanksionuese, të cilat janë në kundërshtim me dispozitat e ligjit për kundërvajtje.

Kosto

Për implementimin e këtij opsioni të propozuar kosto buxhetore është paraparë me Ligjin mbi Buxhetin për vitin 2018 e cila është paraqitur në tabelën në vijim:

Përmbledhje e Vlerësimit të Ndikimit Financiar				
	(000 Euro)			
	Viti aktual	Viti 2	Viti 3	Viti 4
Opsioni 1				
Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve	670,500	979,060	997,513	1,016,888
Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave	2,500,000	3,000,000	2,600,000	2,700,000
Financimi i pritur nga donatorët	0.00	0.00	0.00	0.00
Opsioni 2				
Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve	670,500	979,060	997,513	1,016,888
Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave	2,500,000	3,000,000	2,600,000	2,700,000
Financimi i pritur nga donatorët	0.00	0.00	0.00	0.00
Opsioni 3				
Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve	670,500	979,060	997,513	1,016,888
Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave	2,500,000	3,000,000	2,600,000	2,700,000
Financimi i pritur nga donatorët	0.00	0.00	0.00	0.00

Kapitulli VII: Konsultimi

Ky koncept dokument, ka ardhur në bazë të nevojave të rregullimit për plotësim ndryshimin e ligjit aktual. Procesi i konsultimit të jashtëm, do të bëhet sipas Rregullores nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë dhe Udhëzuesit për Procesin e Konsultimeve Publike (shtator 2011) ku palëve të lartëcekura ua kemi dërguar draftin fillestar të këtij koncept dokumentit. Nga këto konsulta është arritur përfundimi se ndryshimet e lartpërmendura janë më se të domosdoshme. Po ashtu ky KD para procedimit për miratim në Qeveri, do të dërgohet në

konsultim paraprak ndërministror dhe në konsultim publik, përmes platformës së konsultimeve publike.

Komente ka pasur vetëm nga Zyra e Kryeministrit, të cilat janë shqyrtuar nga ekipi për hartimin e koncept dokumentit dhe zyrtarët e Zyrës së Kryeministrit.

Kapitulli VIII: Krahasimi i opsioneve

Opsioni 1: Vazhdimi i zbatimit të ligjit aktual do të pamundësonte dhënien e të drejtës së qytetarëve nën moshën 16 vjeçare për tu pajisur me letërnjoftim si dhe do të krijonte vështirësi në zbatim sidomos me rastin e zbatimit të dispozitave sanksionuese të cilat nuk janë në harmoni me ligjin e ri për kundërvajtje.

Opsioni 2: Me plotësim ndryshimin e ligjit aktual do të jipet e drejta për qytetarët nën moshën 16 vjeçare për tu pajisur me letërnjoftim, dokument i cili do të shërbejë për identifikim më të lehtë të fëmijëve në institucionet shëndetësore, arsimore, dhe shërbime elektronike. Poashtu, plotësim ndryshimi i ligjit aktual do të harmonizonte dispozitat e këtij ligji në të cilat parashihen gjobat me dispozitat e ligjit të ri për kundërvajtje.

Opsioni 3: Çdo ndryshim i qasjes ekzistuese të zbatimit të ligjit aktual nuk do të jipte të drejtën qytetarëve nën moshën 16 vjeçare për tu pajisur me letërnjoftim, sepse kjo e drejtë nuk mund të jipet kësaj kategorie të qytetarëve pa plotësim ndryshimin e ligjit aktual dhe harmonizimin e këtij ligji me legjislacionin tjetër relevant.

Opsioni 1: Është i pafavorshëm për tu zbatuar në situatën aktuale, pasi që edhe më tej qytetarëve prej lindjes deri në moshën 16 vjeçare nuk u mundësohet e drejta e pajisjes me letërnjoftim.

Opsioni 2: Është më i favorshmi pasi që rregullon kornizën ligjore për lëshimin e letërnjoftimeve për të gjithë qytetarët, pa dallim moshe.

Opsioni 3: Është i pafavorshëm pasi që bie ndesh me dispozitat aktuale ligjore.

Kapitulli IX: Rekomandimi

Ky koncept dokument do të paraprijë plotësim ndryshimit të kornizës ligjore aktuale duke i krijuar mundësinë për qytetarët nën moshën 16 vjeçare për tu pajisur me letërnjoftim, dokument i cili do të shërbejë për identifikim më të lehtë të fëmijëve në institucionet shëndetësore, arsimore, dhe qasje në internet. Poashtu, plotësim ndryshimi i ligjit aktual do të harmonizonte dispozitat e këtij ligji në të cilat parashihen gjobat me dispozitat e ligjit të ri për kundërvajtje.

Ministria e Punëve të Brendshme do të vazhdojë të jetë autoriteti i cili lëshon letërnjoftimet në vazhdimësi pa ndonjëkosto shtesë.

Duke pasur parasysh të gjitha opsionet, si dhe pasojat negative dhe përfitimet e mundshme nga të gjitha opsionet, propozohet që të miratohet opsioni 2 si më i favorshmi.

Kapitulli X: Komunikimi

Me rastin e miratimit të këtij Ligji Ministria e Punëve të Brendshme do të njoftoj palët e interesit përmes organizimit të konferencës për shtyp dhe vendosjes së njoftimeve në të gjitha Qendrat për Pajisje me Dokumente. Mesazhi kryesor do të jetë njoftimi i qytetarëve rreth mundësive të reja të cilat do të sjell letërnjoftimi, të tilla si: shfrytëzimi i letërnjoftimit si dokument udhëtimi në vendet fqinje (gjë që rregullohet me marrëveshje), dhe shfrytëzimi i pjesës elektronike të letërnjoftimit për shërbime elektronike.